

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË DURRES
NR. 215 Rep.
NR. 118 Kol.



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË
FORMËS “BOT” PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“HOLTA KABASH” DHE “HOLTA POROCAN”**

Në Tiranë, më datë 29, muaji Mars, viti 2012 (dy mijë e dyqind e një),
para meje noter Joana M. Kushe, anëtar i dhomës së Noterisë Durres, me adresë
Blv. Kriqesor Nr. 3, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në cilësinë e Autoritetit
Kontraktues, përfaqësuar nga z. Nasip Naço, i datëlindjes _____, madhor dhe me
zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi nr.

DHE

Shoqëria koncesionare “HEC-i Kabash – Porocan” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si
person juridik ne QKR me NIPT _____ date _____, përfaqësuar nga
administratori Z. Refat Mustafaraj, i datëlindjes _____, nadhor dhe me zotësi
juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta
nr. _____.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së koncesionit
të formës BOT, të nënshkruar nga palët Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
dhe Shoqëria “Atlas” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “HOLTA KABASH” dhe
“HOLTA POROCAN”, datë 06 Tetor 2008, me Nr. 4581 Rep., nr. 3418 Kol., miratuar
me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1396, datë 17.10.2008.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:



- Në VKM nr. 27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu V, pika 2 (a), i ndryshuar, është parashikuar se “...Autoriteti Kontraktor, në bazë të një vlerësimi, mund të japë një afat deri në 12 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet deri në 5 MW, deri 18 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion me kapacitet nga 5 deri 20 MW dhe deri në 24 muaj, për kontratat e ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion mbi 20 MW, për marrje lejeje dhe përgatitje projekti” dhe “...Të gjitha shoqëritë koncesionare, të cilat, deri në hyrjen të fuqi të këtij vendimi, nuk e kanë parashikuar afatin e nevojshëm të marrjes së këtyre lejeve në kontratat koncesionare përkatëse, kanë të drejtë ta shtyjnë afatin.....

.... Shtyrja e afatit të pasqyrohet, për çdo rast, në kontratat shtesë të palëve në koncesion. Ministri përgjegjës i miraton këto kontrata, të cilat hyjnë në fuqi me firmosjen e saj nga palët.” .

- në Grafikun e Punimeve (Aneksi 2) nuk është parashikuar afati për marrjen e lejeve.(pika 5 (a), e Udhëzimit).
- Referuar Pikës 6 (a), të Udhëzimit Nr.873, datë 13.12.2010 “Për përcaktimin e kritereve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara”, koncesionari ka të drejtë të përfitojë **12 muaj shtesë afati** për vënien në shfrytëzim të hidrocentraleve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me shkresën e saj me nr. 1839/8 Prot., datë 09.02.2011, ka miratuar kërkesën për zgjatjen e afatit të ndërtimit për hidrocentralet “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”.

Në Kontratën e koncesionit të formës BOT për ndërtimin e hidrocentraleve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”, të nënshkruar nga palët, datë 06 Tetor 2008, me Nr. 4581 Rep., nr. 3418 Kol., miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1396, datë 17.10.2008, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10, “Programi i punimeve“:

Pika 2, zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 36 (tridhjetjashte) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është 24 muaj si e parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur.”

Neni 2

Në nenin 23, “Sanksionet“:

Paragrafi i pare, zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të afatit të parashikuar në nenin 10, penalizon koncesionarin, si më poshtë:..”

Neni 3

Kjo kontrate shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe une noteria e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga :

z. Nasip NAÇO

SHOQERIA KONCESIONARE

“HEC-i Kabash-Porocan” sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

z. Refat MUSTAFARAJ

